



**GRUPI  
KËSHILLIMOR  
I STABILITETIT  
FINANCIAR**

Tiranë, në 16.06.2015

**NJOFTIM PËR SHTYP**

**Mbi mbledhjen e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar**

---

Në datën 15 qershor 2015, u zhvillua mbledhja e radhës e Grupit Këshillimor të Stabilitetit Financiar (GKSF). Në këtë mbledhje morën pjesë Ministri i Financave, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe përfaqësues të tjerë të këtyre institucioneve. Mbledhja iu kushtua analizës së veprimtarisë së sektorit bankar dhe sistemit financiar, si edhe vlerësimit të ndikimit të mundshëm prej zhvillimeve në Eurozonë dhe posaçërisht në Greqi. Diskutimet e të pranishmëve u mbështetën edhe në prezantimet e përgatitura nga Banka e Shqipërisë.

Në mënyrë të ngjashme me konkluzionet e mbledhjes së muajit maj 2015, pas analizës në takim, GKSF rikonfirmon edhe një herë se gjendja financiare e sektorit bankar është e mirë. Treguesit e kapitalizimit, të likuiditetit dhe të performancës financiare janë në nivele të larta, duke ofruar mbështetje solide për zhvillimin e veprimtarisë. Për bankat shqiptare me kapital grek, të cilat i nënshtrohen plotësisht kuadrit mbikëqyrës shqiptar, treguesit e mësipërm mbeten pranë ose më lart se nivelet mesatare të sektorit. Ekspozimi i tyre ndaj subjekteve e instrumenteve financiare greke, mbetet gjithashtu në nivele mjaft të ulëta. Rezultatet e ushtrimeve të provës së rezistencës, vijnë të tregojnë se gjendja financiare dhe veprimet e ndryshme rëstrukturose që kanë ndërmarrë këto banka, i mbrojnë efektivisht ato në rastin e zhvillimeve të pafavorshme në Greqi.

Në kuadrin e analizës më të përgjithshme për stabilitetin financiar, pjesëmarrësit në mbledhje u informuan për veprimet e deritanishme nga Ministria e Financave lidhur me huamarrjen prej 250 milionë euro nga tregu ndërkombëtar, me garanci të Bankës Botërore për 200 milionë euro. Huamarrja me garanci nuk rrit kufirin e borxhit, por zëvendëson borxhin e brendshëm me borxh të jashtëm duke rritur më tej hapësirat për huadhënie në sektorin privat nga bankat. Pjesëmarrësit u

informuan gjithashtu mbi veprimet e tjera lidhur me procesin e riemimit të Eurobondit. Kjo ngjarje e afërt, do të përmirësojë treguesit e borxhit publik dhe strukturën e tij.

Në përputhje me objektivin e tij, GKSF-ja do të vazhdojë të monitorojë dhe të analizojë rregullisht zhvillimet në sektorin bankar dhe në të gjithë sistemin financiar.